

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Shërbimi Sprovues i Kosovës - Probaciona Služba Kosova -
Kosovo Probation Service

Prishtinë: 05.08.2026

Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 1, nën paragrafi 1.9 të ligjit nr.08/L-129 për Shërbimin Sprovues të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues të Kosovës nxjerr:

V E N D I M

I. Miratohet Strategjia e Zhvillimit të Kapaciteteve dhe Trajnimit në Shërbimin Sprovues (2026-2028) për Shërbimin Sprovues të Kosovës.

II. Strategjia e Zhvillimit të Kapaciteteve dhe Trajnimit në Shërbimin Sprovues (2026-2028) do të zbatohet nga Drejtoria e Përgjithshme dhe të gjitha Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Sprovues të Kosovës.


III. Vendimi hyn në fuqi nga data 05 Gusht 2026.

Arsim TAHIRI

Drejtör i Përgjithshëm
Shërbimi Sprovues i Kosovës

Vendimi ju dërgohet:

1. Drejtorive Rajonale;
2. Arkivit të SHSK-së.



SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË KAPACITETEVE DHE TRAJNIMIT NË SHËRBIMIN SPROVUES (2026-2028)

Prishtinë, 2026




TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
Vizioni	4
Misioni.....	4
Qëllimi.....	4
I. OBJEKTIVAT	6
Objektivat afatgjata	6
Objektivat afatshkurtra	6
1. Identifikimi i nevojave për trajnim për secilën kategori të stafit.....	6
2. Hartimi dhe zhvillimi i programeve të trajnimit.....	7
3. Organizimi dhe implementimi i trajnimeve.....	7
4. Monitorimi dhe vlerësimi i efektivitetit të trajnimeve	7
II. PLANIFIKIMI DHE NEVOJAT	8
III. TRAJNIMET DHE METODAT E ZHVILLIMIT PROFESIONAL	9
Llojet e trajnimeve.....	9
Metodat e trajnimit.....	10
IV. PËRMBAJTJA DHE KURRIKULA	11
Trajnim bazë.....	11
Trajnim i avancuar	11
Trajnim i specializuar.....	11
V. PLANI I ZBATIMIT / PLANI I VEPRIMIT	12
VI. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË	12
Metodat për vlerësimin e efektivitetit	12
Sistemet e reagimit (feedback).....	12
PËRFUNDIM	14
ANEKSI 1: PLANI I TRAJNIMIT NË SHËRBIMIN SPROVUES TË KOSOVËS (2026-2028)	15
ANEKSI 2: PLANI I VEPRIMIT PËR TRAJNIM NË SHËRBIMIN SPROVUES TË KOSOVËS (2026-2028)	17

HYRJE

Puna e SHSK-së karakterizohet nga një sërë parimesh themelore që udhëheqin veprimtarinë e saj dhe sigurojnë integritetin institucional. Ndër këto parime përfshihen parimi i ligjshmërisë, i cili garanton që çdo veprim dhe vendim të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi; parimi i efektivitetit dhe efikasitetit, që synon arritjen e rezultateve konkrete me përdorim optimal të burimeve; parimi i barazisë dhe mos diskriminimit, që siguron trajtim të drejtë dhe të barabartë për të gjithë përfituesit e shërbimeve pa dallim; si dhe parimi i komunikimit, i cili nënkupton transparencë, bashkëpunim dhe shkëmbim të vazhdueshëm informacioni si brenda institucionit ashtu edhe me palët e interesit.

Për të garantuar zbatimin e këtyre parimeve në mënyrë të qëndrueshme dhe të besueshme, është thelbësore që stafi i SHSK-së të pajiset me njohuri dhe aftësi të përshtatshme profesionale përmes trajnimeve të strukturuar dhe të vazhdueshme. Trajnimi nuk duhet të konsiderohet vetëm si një aktivitet mbështetës, por si një komponent kyç në zhvillimin institucional dhe në ngritjen e cilësisë së shërbimeve.

Në këtë kontekst, ofrimi i trajnimit bazik për stafin e ri është i domosdoshëm për t'i njohur ata me standardet profesionale, procedurat e punës dhe vlerat institucionale. Paralelisht, trajnimi i vazhdueshëm për stafin ekzistues shërben për përditësimin e njohurive, zhvillimin e kompetencave të reja dhe përshtatjen me ndryshimet ligjore, sociale dhe institucionale.

Qëllimi i kësaj strategjie është të strukturoj qasjen e SHSK-së ndaj trajnimit, duke përcaktuar prioritetet, mekanizmat dhe standardet për zhvillimin profesional të stafit. Përmes një qasjeje të tillë sistematike, SHSK-ja synon të rrisë nivelin e profesionalizmit, të forcojë kapacitetet institucionale dhe të sigurojë qëndrueshmëri më të lartë në ofrimin e shërbimeve, në përputhje me praktikën më të mira dhe kërkesat bashkëkohore.

Vizioni

Shërbimi Sprovues i Kosovës synon të zhvillojë një staf profesional, të kualifikuar dhe të përkushtuar, i cili posedon njohuri bashkëkohore dhe aftësi praktike për të zbatuar në mënyrë efektive mandatin institucional. Trajnimi bazë dhe i avancuar duhet t'u ofrohet të gjithë kategorive të stafit, duke përfshirë: zyrtarët sprovues, zyrtarët e lartë, stafin administrativ dhe menaxherial.

Misioni

Misioni i strategjisë së trajnimeve të Shërbimit Sprovues të Kosovës është të sigurojë zhvillim profesional të vazhdueshëm për të gjitha kategoritë e stafit, përmes programeve trajnuese cilësore, bashkëkohore dhe të orientuara drejt praktikës profesionale. Përmes ngritjes së njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale, strategjia synon të forcojë kapacitetet institucionale, të përmirësojë performancën dhe të sigurojë zbatim efektiv, etik dhe profesional të mandatit të Shërbimit Sprovues të Kosovës, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Qëllimi

Qëllimi i kësaj strategjie të trajnimit është të ofrojë një qasje të strukturuar, sistematike dhe të orientuar drejt rezultateve për zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të punonjësve. Përmes kësaj qasjeje synohet që stafi të jetë i aftë të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë e tij në mënyrë profesionale, efektive dhe në përputhje me standardet institucionale, duke u përshtatur njëkohësisht me ndryshimet dhe nevojat në zhvillim të institucionit.

Në mënyrë më specifike, kjo strategji synon të:

- **Përmirësojë performancën** – Duke pajisur punonjësit me njohuritë, mjetet dhe metodat e nevojshme, rritet produktiviteti dhe cilësia e punës, si dhe aftësia për të përballuar sfidat profesionale në mënyrë efikase.
- **Mbështesë arritjen e qëllimeve organizative** – Përmes zhvillimit të kapaciteteve njerëzore, synohet harmonizimi i aftësive dhe kompetencave të punonjësve me objektivat strategjike të Shërbimit Sprovues të Kosovës, duke kontribuar në qëndrueshmëri institucionale dhe rritje të vazhdueshme.

Strategjia e Zhvillimit të Kapaciteteve dhe Trajnimit në Shërbimin Sprovues

- **Nxisë të nxëniet e vazhdueshëm** – Duke promovuar një kulturë organizative që inkurajon zhvillimin profesional të vazhdueshëm, përshtatshmërinë ndaj ndryshimeve dhe inovacionin në punë.
- **Rrisë angazhimin dhe profesionalizmin** – Investimi në zhvillimin profesional ndikon drejtpërdrejt në rritjen e motivimit, kënaqësisë në punë dhe besnikërisë së punonjësve ndaj institucionit, duke forcuar njëkohësisht etikën dhe standardet profesionale.

Në tërësi, kjo strategji synon të krijojë një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e burimeve njerëzore, duke e pozicionuar trajnimin si një instrument kyç për përmirësimin e performancës individuale dhe institucionale.

I. OBJEKTIVAT

Programet e trajnimit duhet të përfshijnë si kurse bazë për stafin e ri, ashtu edhe trajnime të avancuara për zhvillim të mëtejshëm profesional, duke mbuluar tema prioritare dhe fusha të reja në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, përfshirë ato të Këshillit të Evropës.

Pjesëmarrja në trajnime duhet të konsiderohet si pjesë integrale e zhvillimit profesional dhe të reflektohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në proceset e vlerësimit të performancës dhe avancimit në karrierë.

Objektivat afatgjata

- Ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe të institucionalizuar të trajnimit për të gjithë stafin.
- Rritja e vazhdueshme e profesionalizmit dhe standardeve të punës në përputhje me praktikatat evropiane.
- Zhvillimi i kapaciteteve për të adresuar sfida komplekse në fushën e mbikëqyrjes dhe rehabilitimit.
- Integrimi i trajnimit si komponent kyç në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe planifikimin strategjik.

Objektivat afatshkurtra

Objektivat afatshkurtra synojnë ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe efektiv të menaxhimit të trajnimeve në SHSK.

1. Identifikimi i nevojave për trajnim për secilën kategori të stafit

- 1.1 Analiza sistematike e nevojave për trajnim për të gjitha kategoritë e stafit.
- 1.2 Krijimi i një baze të të dhënave për menaxhimin dhe planifikimin e trajnimeve.
- 1.3 Hartimi i profileve të kompetencave dhe mungesave në aftësi profesionale

2. Hartimi dhe zhvillimi i programeve të trajnimit

- 2.1 Hartimi dhe zbatimi i programeve bazë dhe të avancuara të trajnimit.
- 2.2 Zhvillimi i programeve të standardizuara për trajnimin bazë.
- 2.3 Zhvillimi i programeve për aftësi menaxheriale dhe praktika profesionale (internship).

3. Organizimi dhe implementimi i trajnimeve

- 3.1 Organizimi i trajnimeve të rregullta në temat prioritare.
- 3.2 Organizimi i trajnimeve bazike dhe të avancuara për stafin.
- 3.3 Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimeve të specializuara sipas nevojave specifike.

4. Monitorimi dhe vlerësimi i efektivitetit të trajnimeve

- 4.1 Vendosja e mekanizmave për monitorimin dhe vlerësimin e trajnimeve.
- 4.2 Zbatimi i sistemeve të feedback-ut nga pjesëmarrësit dhe trajnerët.
- 4.3 Analiza e rezultateve dhe përmirësimi i vazhdueshëm i programeve të trajnimit.

II. PLANIFIKIMI DHE NEVOJAT

Planifikimi i trajnimeve në kuadër të Shërbimit Sprovues të Kosovës (SHSK) bazohet në një qasje sistematike dhe të orientuar drejt nevojave reale të institucionit dhe stafit të tij. Ky proces synon të sigurojë që të gjithë punonjësit të pajisen me kompetencat e nevojshme për të ushtruar detyrat e tyre në mënyrë profesionale, efektive dhe në përputhje me standardet e përcaktuara. Trajnimi bazë përbën një komponent thelbësor të zhvillimit fillestar profesional dhe u ofrohet të gjithë zyrtarëve sprovues, të rinjë në shërbimin sprovues. Çdo zyrtar është i obliguar të ndjekë dy kurse bazë gjatë vitit të parë të punësimit, të cilat synojnë t'i pajisin ata me njohuritë themelore mbi mandatin institucional, procedurat operative, etikën profesionale dhe standardet e punës.

Ndërkohë, trajnimet e avancuara organizohen në mënyrë të vazhdueshme dhe fleksibile, duke u bazuar në:

- nevojat strategjike të SHSK-së,
- specifikat dhe prioritetet e Zyrrave Rajonale,
- si dhe fushën e përgjegjësisë dhe profilin profesional të secilit zyrtar.

Këto trajnime synojnë të thellojnë njohuritë profesionale, të zhvillojnë aftësi të specializuara dhe të adresojnë sfida konkrete që lidhen me praktikën e përditshme të punës.

Një element kyç i këtij procesi është analiza vjetore e nevojave për trajnim, e cila realizohet nga SHSK me qëllim identifikimin e boshllëqeve në kompetenca dhe përcaktimin e prioritetëve për zhvillim profesional. Kjo analizë bazohet në disa burime, përfshirë:

- vlerësimet e performancës së stafit,
- ndryshimet në legjislacion dhe politika institucionale,
- kërkesat operative dhe sfidat praktike,
- si dhe rekomandimet nga menaxhmenti dhe partnerët relevantë.

Në bazë të kësaj analize hartohet plani vjetor i trajnimeve, ku përcaktohen temat, grupet përfituese, format e trajnimit dhe afatet kohore për realizim.

Përveç nevojave institucionale, rëndësi e veçantë i kushtohet edhe kërkesave individuale të punonjësve, duke marrë parasysh interesat e tyre profesionale, aspiratat për zhvillim në karrierë dhe nevojën për specializim në fusha të caktuara. Kjo qasje kontribuon në rritjen e motivimit, angazhimit dhe performancës së stafit.

Në tërësi, planifikimi i trajnimeve në SHSK synon të krijojë një sistem të balancuar dhe të qëndrueshëm të zhvillimit profesional, ku ndërthuren nevojat institucionale me ato individuale, duke siguruar një staf të përgatitur dhe të aftë për të përmbushur me sukses misionin e tij.

III. TRAJNIMET DHE METODAT E ZHVILLIMIT PROFESIONAL

Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK), me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve profesionale dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, organizon dhe zhvillon një gamë të gjerë trajnimesh të strukturuar sipas nevojave të stafit dhe prioriteteve institucionale.

Llojet e trajnimeve

- **Trajnime bazë për zyrtarët sprovues**

Këto trajnime janë të detyrueshme për stafin e ri dhe synojnë pajisjen e tyre me njohuritë themelore mbi mandatin e SHSK-së, procedurat operative, etikën profesionale, komunikimin me palët dhe standardet e punës.

- **Trajnime të avancuara për zyrtarët sprovues dhe zyrtarë të lartë sprovues**

Fokusohen në zhvillimin e aftësive të avancuara dhe thellimin e njohurive në fusha specifike, si menaxhimi i rasteve, rehabilitimi dhe riintegrimi, vlerësimi i rrezikut, puna me kategori të veçanta dhe trajtimi i rasteve komplekse.

- **Trajnime të specializuara për zyrtarët sprovues dhe zyrtarë të lartë sprovues**

- Fokusohet në zhvillimin e aftësive të specializuara me programe të veçanta për rehabilitim dhe riintegrim, siç janë Biseda për ndryshim, menaxhimi i zemërimit, programet psiko sociale etj.

- **Trajnimi i trajnerëve (Training of Trainers – ToT)**

Synon krijimin dhe zhvillimin e një rrjeti të brendshëm trajnerësh të certifikuar, të cilët janë në gjendje të përcjellin njohuri dhe praktika profesionale brenda institucionit, duke siguruar qëndrueshmëri dhe pavarësi në ofrimin e trajnimeve.

- **Trajnime për menaxhim dhe lidërsip**

Të dedikuara për stafin menaxherial dhe drejtues, këto trajnime fokusohen në zhvillimin e aftësive të udhëheqjes, menaxhimit të burimeve njerëzore, vendimmarrjes strategjike, planifikimit dhe menaxhimit të performancës.

- **Trajnime ndërdisiplinore dhe tematike**

Përfshijnë fusha si komunikimi ndërinstitutional, të drejtat e njeriut, barazia gjinore, menaxhimi i stresit, si dhe tema të tjera relevante për zhvillimin gjithëpërfshirës të stafit.

Metodat e trajnimit

SHSK përdor një qasje të kombinuar dhe fleksibile të metodave të trajnimit, duke synuar maksimalizimin e përvetësimit të njohurive dhe zhvillimit të aftësive praktike.

- **Metodat tradicionale**

Përfshijnë ligjërata, seminare dhe prezantime, të cilat shërbejnë për transmetimin e njohurive teorike dhe kuadrit konceptual.

- **Trajnimi ballë për ballë (face-to-face)**

Konsiderohet si metodë bazë dhe efektive për zhvillimin e aftësive praktike, ndërveprimin direkt dhe diskutimet profesionale. Kjo metodë mundëson shkëmbim të përvojave dhe ndërtim të bashkëpunimit ndërmjet pjesëmarrësve.

- **Të nxënit interaktiv**

Përfshin diskutime në grup, punë në ekipe, analiza të rasteve, teknikat profesionale, duke inkurajuar pjesëmarrje aktive dhe mendim kritik.

- **Mësimi elektronik (e-learning)**

Përdorimi i platformave digjitale për ofrimin e trajnimeve online, që mundëson fleksibilitet në kohë dhe qasje më të gjerë për stafin, veçanërisht për temat teorike dhe përditësimet e shpejta.

- **Mjete digjitale dhe aplikacione**

Përfshijnë përdorimin e platformave edukative, aplikacioneve për trajnim, video-materialeve dhe burimeve interaktive që mbështesin procesin e të nxënit.

- **Ushtrime praktike dhe simulime**

Janë thelbësore për zhvillimin e aftësive profesionale, duke përfshirë role-play, simulime të situatave reale, analiza të skenarëve dhe ushtrime praktike që ndihmojnë në aplikimin e njohurive në praktikë.

IV. PËRMBAJTJA DHE KURRIKULA

Trajnim bazë

Zyrtari sprovues është përgjegjës për mbikëqyrjen e masave dhe dënimeve alternative, ne zbatimin e detyrave, risocializimit, riintegritit dhe rehabilitim të të gjithë personave që kanë kryer vepra penale të dënueshme sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës. Qëllimi i kursit bazë është pajisja e zyrtarit sprovues me njohuri dhe instrumente për të qenë në gjendje të kryejë punën e tij në mënyrë profesionale dhe efikase në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane. Kursi bazë është i ndarë në dy sesione, ku secili sesion ka një temë specifike dhe kohëzgjatja e secilit sesion është një javë. Zyrtari sprovues duhet të përfundojë dy sesione bazë brenda vitit të parë të punësimit.

Trajnim i avancuar

Qëllimi i kurseve të avancuara është të vazhdojë të zhvillojë kompetencën e zyrtarit sprovues dhe zyrtarit të lartë përmes rritjes së njohurive dhe instrumenteve shtesë në mënyrë që të kryejë punën e tij me klientët në mbikëqyrje sprovuese në një mënyrë profesionale dhe efikase në përputhje me standardet e punës dhe legjislacionin në fuqi . Kurset e avancuara zgjasin një javë dhe përqendrohen në një temë specifike. Çdo zyrtar mund të ndjekë një ose më shumë kurse të avancuara gjatë një viti. Mësimi i vazhdueshëm është një mënyrë për të siguruar cilësi të mirë dhe të avancuar në punën sprovuese.

Trajnim i specializuar

Qëllimi i kurseve të specializuara është të vazhdojë të zhvillojë kompetencën e zyrtarit sprovues dhe zyrtarit të lartë përmes rritjes së njohurive dhe instrumenteve shtesë në mënyrë që të kryejë punën e tij me klientët në mbikëqyrje në një mënyrë profesionale dhe efikase në përputhje me standardet e punës dhe legjislacionin në fuqi . Kurset e specializuara zgjasin një javë dhe përqendrohen në një temë specifike. Çdo zyrtar mund të ndjekë një ose më shumë kurse të specializuara gjatë një viti. Mësimi i vazhdueshëm është një mënyrë për të siguruar cilësi të mirë dhe të specializuar në punën sprovuese.

V. PLANI I ZBATIMIT / PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit i Strategjisë i cili përshkruan në detaje do të jetë i bashkëngjitur si aneks i këtij dokumenti së bashku me pjesën tabelare të ndarjeve të trajnimeve.

VI. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të strategjisë së trajnimeve përbëjnë komponentë thelbësorë të ciklit të trajnimit në Shërbimin Sprovues të Kosovës (SHSK), duke siguruar që programet e trajnimit të jenë efektive, relevante dhe në përputhje me objektivat strategjike të institucionit. Ky proces mundëson matjen e rezultateve, identifikimin e përmirësimeve të nevojshme dhe rritjen e vazhdueshme të cilësisë së trajnimeve.

Metodat për vlerësimin e efektivitetit

Për të siguruar një vlerësim të plotë dhe të besueshëm, do të përdor një kombinim metodash cilësore dhe sasiore, si në vijim:

- **Vlerësimi para dhe pas trajnimit (pre-test dhe post-test)**
Mat nivelin e njohurive dhe aftësive të pjesëmarrësve para dhe pas trajnimit, duke identifikuar progresin e arritur.
- **Vlerësimi i performancës në vendin e punës**
Analizon ndikimin e trajnimit në praktikën e përditshme të punonjësve, përmes vëzhgimit, raporteve të menaxherëve dhe rezultateve konkrete të punës.
- **Vlerësimi i përmbajtjes dhe metodologjisë së trajnimit**
Shqyrton relevancën e temave, cilësinë e materialeve dhe efektivitetin e metodave të përdorura gjatë trajnimit.

Sistemet e reagimit (feedback)

Feedback-u është një element kyç për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të trajnimit dhe përfshin mekanizma të strukturuar për mbledhjen dhe analizimin e mendimeve të pjesëmarrësve dhe aktorëve relevantë:

- **Pyetësorët e vlerësimit pas trajnimit**
Pjesëmarrësit japin vlerësime mbi cilësinë e trajnimit, përmbajtjen, trajnerët dhe organizimin.
- **Diskutime dhe reflektime në grup**
Seanca të hapura ku pjesëmarrësit ndajnë përvoja, sugjerime dhe sfida të hasura gjatë dhe pas trajnimit.

- **Intervista dhe konsultime me menaxherët**

Mbledhja e feedback-ut nga drejtuesit lidhur me ndryshimet në performancën e stafit pas trajnimit.

- **Platforma digjitale për feedback të vazhdueshëm**

Përdorimi i mjeteve online për të mbledhur komente dhe sugjerime në kohë reale.

- **Vetëvlerësimi i pjesëmarrësve**

Inkurajimi i punonjësve për të reflektuar mbi zhvillimin e tyre profesional dhe aplikimin e njohurive në praktikë.

PËRFUNDIM

Kjo strategji e trajnimeve për stafin e Shërbimit Sprovues të Kosovës përfaqëson një qasje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse për zhvillimin profesional të stafit, duke u mbështetur në parime të qarta, planifikim sistematik dhe metoda bashkëkohore të të nxënës. Përmes kombinimit të trajnimeve bazë, të avancuara dhe të specializuara, si dhe identifikimit të vazhdueshëm të nevojave për trajnim, kjo strategji synon të sigurojë ngritjen profesionale të stafit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira evropiane. Në këtë kuadër, trajnimi shihet si një proces i vazhdueshëm që kontribuon në zhvillimin e njohurive, aftësive praktike dhe kompetencave profesionale të nevojshme për ushtrimin efikas të detyrave dhe përgjegjësi institucionale.

Zbatimi i kësaj strategjie pritet të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e performancës së stafit dhe në forcimin e kapaciteteve institucionale të SHSK-së. Përmes programeve të strukturuar trajnuese, stafi do të jetë më i përgatitur për menaxhimin e rasteve, zbatimin e masave dhe dënimeve alternative, si dhe për trajtimin profesional të personave nën mbikëqyrje. Po ashtu, strategjia promovon forcimin e etikës profesionale, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe qasjes multidisiplinare në punë. Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të trajnimeve do të mundësojnë matjen e efektivitetit të tyre dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve trajnuese, duke siguruar që ato të jenë në përputhje me nevojat reale të stafit dhe zhvillimet ligjore e profesionale.

Në perspektivë, SHSK duhet të vazhdojë të investojë në modernizimin e sistemit të trajnimeve, duke zgjeruar përdorimin e teknologjisë dhe platformave digjitale, si dhe duke forcuar bashkëpunimin me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë. Përveç kësaj, avancimi i proceseve të mentorimit, certifikimit profesional dhe zhvillimit të karrierës do të ndikojë në krijimin e një sistemi më funksional dhe të qëndrueshëm të zhvillimit profesional. Një qasje e tillë do të sigurojë që Shërbimi Sprovues i Kosovës të mbetet një institucion modern, profesional dhe i aftë për të përmbushur me sukses mandatin e tij në funksion të drejtësisë, rehabilitimit dhe sigurisë publike.

ANEKSI 1: PLANI I TRAJNIMIT NË SHËRBIMIN SPROVUES TË KOSOVËS (2026-2028)

Më poshtë është një listë e plotë e trajnimeve të ofruara për stafin e SHSK-së, e ndjekur nga një plan veprimi më i detajuar. Të gjitha modulet e rekomanduara duhet të kenë disa trajnerë të trajnuar për të siguruar ekzekutimin e lehtë të trajnimeve të vazhdueshme pa ushtruar shumë presion mbi një numër të vogël individësh të trajnuar.

Lista e plotë e trajnimeve të SHSK-së: kurse bazike, të avancuara dhe specializuara

Kurset bazike të detyrueshme - trajnime	Numri i pjesëmarrësve të trajnuar	Numri i dëshiruar i stafit të SHSK-së të trajnuar/vit	2027	2028
1. Puna si zyrtar sprovues	5	1 grup prej 10 personash	✓	✓
2. Parandalimi i recidivizmit	5	1 grup prej 10 personash	✓	✓
Kurse të avancuara – trajnime	Numri i dëshiruar i trajnerëve të trajnuar	Numri i dëshiruar i stafit të SHSK-së të trajnuar/vit		
1. Mbikëqyrja e masave dhe dënimeve alternative për persona të mitur	5	1 grup prej 10 personash	✓	✓
2. Mbikëqyrja e masave dhe dënimeve alternative për persona madhor	5	1 grup prej 10 personash	✓	✓
3. Raportet dhe vlerësimet	5	1 grup prej 10 personash	✓	✓
4. Mbikëqyrja e llojeve specifike të shkelësve	5	1 grup prej 10 personash	✓	✓
5. Puna me të liruarit me kusht	5	1 grup prej 10 personash	✓	✓
6. Puna për të nxitur ndryshimin	5	1 grup prej 10 personash	✓	✓

Strategjia e Zhvillimit të Kapaciteteve dhe Trajnimit në Shërbimin Sprovues


Intervista Motivuese	5	1 grup prej 10 personash	✓	✓
7. Ngritja e kompetencave digjitale	5	1 grup prej 10 personash	✓	✓
Kurse-trajnime të specializuara	Numri i dëshiruar i trajnerëve të trajnuar	Numri i dëshiruar i stafit të SHSK-së të trajnuar/vit		
1. Puna me programin e trajtimit: Menaxhimi i zemërimit	4	1 grup prej 7 personash	✓	✓
2. Puna me programin e trajtimit: Biseda për ndryshim	4	1 grup prej 7 personash	✓	✓
3. Puna me programin psiko social: Dhuna në familje	4	1 grup prej 7 personash	✓	✓
4. Menaxhimi dhe Burimet Njerëzore	4	1 grup prej 7 personash	✓	✓
5. Puna me programin e trajtimit për personat e radikalizuar	4	1 grup prej 7 personash	✓	✓
6. Trajnimi i trajnerëve	4	Bazuar në nevojat e identifikuar	✓	✓

ANEKSI 2: PLANI I VEPRIMIT PËR TRAJNIM NË SHËRBIMIN SPROVUES TË KOSOVËS (2026-2028)

Orari	Veprimet	Rezultati
VITI 2026	- Hartimi i kurrikulave të trajnimit për kurset bazik dhe të avancuara - Akreditimi i trajnimeve në AKSP - Caktimi i një koordinatori trajnimi për Drejtorinë Qendrore të SHSK-së dhe koordinatorit në AKSP - Përzgjedhja dhe caktimi i trajnerëve -Trajnerët e trajnuar - Hartimi i një plani trajnimi për vitin 2027	- SHSK është i vetëmjaftueshëm në ofrimin e kurseve bazë dhe të avancuara në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane. - Sigurimi i standardeve dhe strukturave të trajnimeve në SHSK - Menaxhim i përmirësuar, i strukturuar dhe i centralizuar i trajnimeve të SHSK-së - SHSK-ja ka një kapacitet trajnimi të vetëmjaftueshme duke ofruar vet trajnerin e të trajnerëve. - Plan i vjetor i shërbimit i përgatitur për vitin 2027
VITI 2027	- Kryerja e 3 trajnimeve bazë për zyrtarët sprovues - Kryerja e 2 (ose më shumë) trajnimeve të avancuara (tituj) për zyrtarët e shërbimit sprovues - Hartimi i kurrikulave të trajnimit për kurset e avancuara -Vlerësimi i kurseve bazë dhe të avancuara të zhvilluara - Hartimi i një plani trajnimi për vitin 2028	- 30 zyrtarë të shërbimit sprovues u trajnuan në kursin bazë gjatë vitit - 20 persona të trajnuar në kurse të avancuara (Titulli i kurseve) gjatë vitit - SHSK-ja ka një kapacitet trajnimi të pavarur në shërbim që ofron kurse të avancuara në përputhje me standardet evropiane dhe praktikat më të mira. - Sigurimi që cilësia të ruhet dhe që përmbajtja të jetë relevante dhe profesionale - Plan i vjetor i shërbimit i përgatitur për vitin 2028
VITI 2028	- Kryerja e 3 trajnimeve bazë për zyrtarët sprovues	- 30 zyrtarë të shërbimit sprovues u trajnuan në kursin bazë gjatë vitit

Strategjia e Zhvillimit të Kapaciteteve dhe Trajnimit në Shërbimin Sprovues

- Kryerja 2 (ose më shumë) trajnime të avancuara për zyrtarët e shërbimit sprovues - Hartimi i kurrikulave të trajnimit për kurset e avancuara - Hartimi i një plani trajnimi për vitin 2029 - Vlerësimi i kurseve bazë dhe të avancuara të zhvilluara	- 20 persona të trajnuar në kurse të avancuara (Titulli i kurseve) gjatë vitit - SHSK-ja ka një mekanizëm trajnimi të pavarur të brendshëm që ofron kurse të avancuara në përputhje me standardet evropiane dhe praktikrat më të mira. - Plan i vjetor i shërbimit i përgatitur për vitin 2029 - Sigurimi që cilësia të ruhet dhe që përmbajtja të jetë relevante dhe profesionale
---	---



SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS

PLANI ZHVILLIMOR STRATEGJIK (2026-2028)

Prishtinë, 2026

FJALA HYRËSE

Kam nderin dhe privilegjin të prezantoj Planin Zhvillimor Strategjik të Shërbimit Sprovues të Kosovës për periudhën 2026–2028, një dokument që pasqyron qartë vizionin tonë për një sistem të drejtësisë më human, më efektiv dhe më të orientuar drejt rezultateve konkrete në shërbim të qytetarëve.

Në një kohë kur sfidat e sigurisë dhe të drejtësisë kërkojnë qasje të balancuar ndërmjet ndëshkimit dhe rehabilitimit, Shërbimi Sprovues i Kosovës pozicionohet si një shtyllë kyçe në avancimin e politikave moderne penale. Vizioni ynë është që përmes zbatimit të masave dhe dënimeve alternative të ndikojmë drejtpërdrejt në uljen e rrezikut nga përsëritja e veprave penale, duke promovuar riintegrimin e qëndrueshëm dhe përgjegjësinë individuale në shoqëri.

Plani Strategjik 2026–2028 shënon një hap të rëndësishëm në konsolidimin institucional dhe në rritjen e kapaciteteve profesionale të Shërbimit Sprovues. Ai vendos prioritete të qarta për zhvillim, duke synuar rritjen e cilësisë së shërbimeve, fuqizimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe avancimin e qasjeve inovative në menaxhimin e rasteve.

Ky plan është në përputhje të plotë me standardet evropiane dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare, duke reflektuar gjithashtu rekomandimet dhe mbështetjen e partnerëve tanë strategjikë. Përmes tij, ne synojmë të forcojmë besimin publik në institucionet e drejtësisë dhe të kontribuojmë në ndërtimin e një shoqërie më të sigurt dhe më gjithëpërfshirëse.

Zbatimi i masave dhe dënimeve alternative, rehabilitimi dhe mbikëqyrja profesionale nuk janë vetëm obligime ligjore, por përfaqësojnë një qasje progresive të politikave penale që vendos në qendër individin dhe mundësinë për ndryshim. Kjo qasje kontribuon drejtpërdrejt në stabilitetin social dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Bashkëpunimi ndërinstitucional mbetet një prioritet strategjik. Përmes partneriteteve të fuqishme me institucionet shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile, synojmë të krijojmë një sistem të integruar që adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse sfidat e rehabilitimit dhe riintegrimin.

Ky Plan Zhvillimor Strategjik përfaqëson një angazhim të qartë institucional për ndërtimin e një Shërbimi Sprovues modern, transparent dhe llogaridhënës, i cili kontribuon në forcimin e rendit dhe ligjit dhe në rritjen e sigurisë në komunitet.

Realizimi i këtij vizioni kërkon përkushtim të përbashkët, lidërsip të qëndrueshëm dhe bashkëpunim të gjerë institucional. Ne mbetemi të vendosur që përmes këtij plani të sjellim ndryshime konkrete dhe të matshme në shoqërinë tonë.

ARSIM TAHIRI

Drejtor i Përgjithshëm
Shërbimi Sprovues i Kosovës

PËRMBAJTJA

AKRONIMET	4
I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	5
Misioni	6
Vizioni.....	6
II. PARIMET E PËRGJITHSHME.....	6
III. METODOLOGJIA	7
IV. OBJEKTIVAT E PLANIT ZHVILLIMOR	8
Objektivi Strategjik 1: Ngritja e sigurisë në komunitet	8
Objektivi Strategjik 2: Forcimi i kapaciteteve organizative	9
Objektivi Strategjik 3: Avancimi i kapaciteteve profesionale të Shërbimit Sprovues.....	9
V. PLANI I VEPRIMIT	10

AKRONIMET

ADK	Akademia e Drejtësisë së Kosovës
AKSP	Akademia e Kosovës për siguri Publike
ASP	Agjensionet për siguri publike
BE	Bashkimi Evropian
CEP	Qendra Evropiane e Sprovimit
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KIE	Këshilli i Evropës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
MD	Ministria e Drejtësisë
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
OJQ	Organizata Joqeveritare
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
OE	Odat Ekonomike
PK	Policia e Kosovës
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
SHSK	Shërbimi Sprovues i Kosovës

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Plani Zhvillimor Strategjik i Shërbimit Sprovues të Kosovës (SHSK) përfaqëson rezultat të një procesi gjithëpërfshirës dhe profesional, të ndërtuar mbi kontributin e zyrtarëve të SHSK-së, ekspertëve të fushës, si dhe partnerëve ndërkombëtarë, përfshirë EULEX-in, OSBE-në, ICITAP-in dhe mekanizma të tjerë mbështetës. Ky bashkëpunim ka siguruar që dokumenti strategjik të jetë në linjë me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe me standardet evropiane në fushën e drejtësisë alternative.

Përmes këtij Plani Zhvillimor Strategjik, Shërbimi Sprovues i Kosovës synon të avancojë drejt një modeli modern dhe të integruar të mbikëqyrjes në komunitet, në përputhje me parimet dhe qasjet bashkëkohore evropiane për trajtimin e personave të dënuar me masa dhe dënime alternative, si dhe të liruarve me kusht. Ky orientim reflekton angazhimin institucional për të kontribuar në ndërtimin e një sistemi të drejtësisë më efikas, human dhe të orientuar drejt riintegrit.

Hartimi i këtij plani ka për qëllim forcimin e rolit të SHSK-së brenda sistemit të drejtësisë, duke e pozicionuar atë si një institucion kyç në zbatimin e masave dhe politikave riintegruese moderne penale. Në të njëjtën kohë, plani synon të avancojë profesionalizmin e zyrtarëve sprovues dhe të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm institucional, në përputhje me kërkesat dhe trendet evropiane në menaxhimin e rasteve dhe mbikëqyrjen në komunitet.

Një ndër elementet thelbësore të këtij plani është garantimi i zbatimit të ligjeve në fuqi në mënyrë të drejtë dhe efektive, duke respektuar plotësisht të drejtat dhe dinjitetin e njeriut, në përputhje me instrumentet ndërkombëtare dhe standardet e Bashkimit Evropian, si për të miturit ashtu edhe për personat madhorë në konflikt me ligjin.

Në kuadër të Planit Zhvillimor Strategjik janë përcaktuar tre (3) objektiva strategjike, të cilat reflektojnë prioritetet kryesore zhvillimore dhe janë në harmoni me praktikën evropiane për siguri publike dhe rehabilitim:

Objektivat e parapara të Planit Zhvillimor Strategjik të Shërbimit Sprovues janë:

1. Ngritja e sigurisë në komunitet
2. Forcimi i kapaciteteve organizative
3. Avancimi i kapaciteteve profesionale të Shërbimit Sprovues

Brenda secilit objektiv strategjik janë përcaktuar objektiva specifike dhe aktivitete konkrete, të cilat synojnë arritjen e rezultateve të matshme dhe përmbushjen efektive të këtij plani. Kjo qasje siguron një orientim të qartë drejt performancës, llogaridhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm, në përputhje me parimet e administratës moderne evropiane.

MISIONI

Përmes kësaj Strategjie synohet të realizohet Misioni i Shërbimit Sprovues i cili përcaktohet me Ligjin Nr.. 08/L-129 për Shërbimin Sprovues të Kosovës, i cili ka për qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin shoqëror të personave nën mbikëqyrje, gjithashtu, parandalimin e veprave penale dhe uljen e rrezikut të përsëritjes së tyre, si dhe të kontribuojë në mbrojtjen e interesit publik.

VIZIONI

Vizioni i këtij Plani Zhvillimor Strategjik është ndërtimi i një shërbimi modern, profesional dhe efikas që promovon vlera në ri-integrim që të arrihet një komunitet më i sigurt ndërtuar mbi respektimin e dinjitetit njerëzor i cili ndihmon ngritjen e sigurisë shoqërore në përgjithësi.

II. PARIMET E PËRGJITHSHME

Shërbimi Sprovues udhëhiqet nga parimet e përgjithshme si:

- **Profesionalizëm, transparencë dhe llogaridhënie** – Angazhim për ushtrimin e detyrave në mënyrë profesionale, të paanshme dhe në përputhje me ligjin, duke siguruar transparencë në veprim dhe përgjegjësi të plotë për vendimmarrjen dhe rezultatet e punës.
- **Bashkëpunim dhe partneritet** – Ndërtimi dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, si dhe me shoqërinë civile, me qëllim rritjen e efikasitetit, shkëmbimin e praktikave më të mira dhe ofrimin e shërbimeve cilësore në komunitet.
- **Integritet dhe etikë profesionale** – Zbatimi i standardeve të larta etike në çdo aspekt të punës, duke garantuar korrektësi, paanshmëri dhe respekt në trajtimin e të gjithë personave.

- **Respektimi i të drejtave të njeriut dhe dinjitetit njerëzor** – Sigurimi që çdo veprim dhe ndërveprim të jetë në përputhje me parimet themelore të të drejtave të njeriut, duke trajtuar çdo individ me dinjitet, pa diskriminim dhe me ndjeshmëri profesionale.
- **Qasje rehabilituese dhe riintegruese** – Promovimi i një qasjeje që mbështet ndryshimin pozitiv të individit, riintegrimin e qëndrueshëm në shoqëri dhe zvogëlimin e rrezikut të përsëritjes së veprave penale.
- **Qëndrueshmëria institucionale**-Kapacitetet institucionale për tu siguruar qëndrueshmëri për resurse dhe kompetenca.

III. METODOLOGJIA

Plani Zhvillimor Strategjik i Shërbimit Sprovues të Kosovës është ndërtuar mbi parimet themelore që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, legjislacioni në fuqi dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe drejtësinë penale. Ky plan reflekton gjithashtu praktikën më të mirë ndërkombëtare në fushën e zbatimit të dënimeve alternative, duke synuar aplikimin e standardeve më të avancuara profesionale dhe institucionale.

Procesi i planifikimit strategjik është karakterizuar nga një qasje gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse, duke përfshirë konsultime të gjera me palët e interesit, institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës, si dhe partnerët ndërkombëtarë. Kjo ka mundësuar një pasqyrim realist të nevojave dhe prioriteteve zhvillimore të Shërbimit Sprovues, si dhe një harmonizim me trendet dhe kërkesat bashkëkohore evropiane.

Hartimit të këtij Plani Zhvillimor Strategjik i kanë paraprirë analiza dhe raporte vlerësimi të punës së Shërbimit Sprovues, të përgatitura nga institucione vendore dhe ndërkombëtare në periudha të ndryshme kohore. Këto dokumente kanë ofruar indikatorë të rëndësishëm dhe evidencë empirike, të cilat kanë shërbyer si bazë për formulimin e objektivave strategjike dhe specifike. Përmes kësaj qasjeje, objektivat janë konkretizuar në masa dhe veprime të zbatueshme, duke siguruar orientim të qartë drejt arritjes së rezultateve të matshme dhe të qëndrueshme.

Metodologjia e hartimit të Planit Zhvillimor Strategjik është bazuar në një kombinim të metodave analitike dhe konsultative, duke përfshirë:

- Studime kualitative përmes organizimit të fokus-grupeve me akterë relevantë; Analizë të literaturës dhe dokumentacionit ekzistues brenda Shërbimit Sprovues; Studim krahasues ndërmjet gjendjes aktuale dhe objektivave zhvillimore për periudhën e ardhshme;
- Shqyrtim dhe integrim të rekomandimeve nga raportet e vlerësimit të SHSK-së të hartuara në periudha të ndryshme;
- Konsultime të drejtpërdrejta me ekspertë dhe partnerë strategjikë për validimin e prioriteteve dhe masave të propozuara.
- Udhëzimet dhe rekomandimet e instrumenteve ndërkombëtare.

Kjo metodologji siguron që Planit Zhvillimor Strategjik të jetë i bazuar në evidencë, i orientuar drejt rezultateve dhe i harmonizuar me standardet moderne të planifikimit strategjik në nivel evropian.

IV. OBJEKTIVAT E PLANIT ZHVILLIMOR

Objektivat e Planit Zhvillimor Strategjik të Shërbimit Sprovues të Kosovës synojnë përmirësimin dhe avancimin e funksionit të mbikëqyrjes së personave të dënuar me masa dhe dënime alternative, duke u harmonizuar ngushtë me prioritetet dhe drejtimet strategjike të Ministrisë së Drejtësisë. Në këtë kontekst, ky plan reflekton përputhshmërinë me kornizën zhvillimore të Ministrisë, e cila parasheh zhvillim të qëndrueshëm dhe forcim institucional për agjencitë në varësi.

Duke u mbështetur në orientimet strategjike të Ministrisë së Drejtësisë për rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe avancimin profesional në funksion të qytetarëve pa dallim, Shërbimi Sprovues ka përcaktuar objektiva që kontribuojnë drejtpërdrejt në realizimin e synimeve të përbashkëta institucionale.

Këto objektiva janë të orientuara drejt forcimit të sundimit të ligjit, rritjes së sigurisë në komunitet dhe ofrimit të shërbimeve efektive dhe të qëndrueshme, në përputhje me prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe standardet bashkëkohore të drejtësisë.

Objektivat e Planit Zhvillimor Strategjik të Shërbimit Sprovues janë:

1. Ngritja e sigurisë në komunitet
2. Forcimi i kapaciteteve organizative
3. Avancimi i kapaciteteve profesionale të Shërbimit Sprovues

Objektivi Strategjik 1: Ngritja e sigurisë në komunitet

Ky objektivi ka për qëllim ngritjen e sigurisë në komunitet përmes realizimit të detyrave të cilat kontribuojnë në rehabilitimin dhe risocializimin e personave të dënuar me dënime alternative. Dënimet alternative janë dëshmuar si mundësia më e mirë në procesin e rehabilitimit, reintegrimit dhe risocializimit për të gjithë personat si shkelës të ligjit dhe ndihmon në uljen e recidivizmit dhe rritjen e sigurisë publike.

Objektiv specifik 1.1: Zbatimi efektiv i masave, dënimeve alternative dhe mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht;

Objektiv specifik 1.2: Mbështetje efektive për rehabilitim dhe risocializim të personave të dënuar.

Objektivi Strategjik 2: Forcimi i kapaciteteve organizative

Përmes këtij objektivi synohet të arrihet forcimi i bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe lokale, organizatat ndërkombetare qeveritare si dhe organizatave joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare. Ky objektivi synohet të arrihet përmes objektivave specifike duke forcuar bashkëpunimin me anë të marrëveshjeve të lidhura me akterët relevant. Nevoja për të bashkëpunuar me komunitetin është domosdoshmëri e cila ndihmon në zbatimin e një numri të madh të dënimeve alternative të cilat ekzekutohen në komunitet përmes bashkëpunimit me institucionet qeveritare dhe joqeveritare.

Objektivi specifik 2.1: Forcimi i bashkëpunimit me akterët e nivelit qendror dhe lokal;

Objektivi specifik 2.2: Forcimi i bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare;

Objektivi specifik 2.3: Forcimi i bashkëpunimit me organizata joqeveritare.

Objektivi Strategjik 3: Avancimi i kapaciteteve profesionale të Shërbimit Sprovues

Objektivi strategjik 3 ka për qëllim që përmes objektivave specifike të ngris kapacitetin profesional të stafit të SHSK-së nëpërmjet trajnimeve, si dhe të përmirësoj kushtet e punës. Kjo synohet të arrihet duke avancuar sistemin e teknologjisë informative dhe mjeteve të punës të cilat do të kenë ndikim në ofrimin e shërbimeve sa më profesionale me qëllim të përmbushjes së detyrave të punës me integritet dhe profesionalizëm konform standardeve.

Objektivi specifik 3.1: Ngritja e aftësive dhe shkathtësive profesionale të stafit të SHSK-së;

Objektivi specifik 3.2: Avancimi i mëtutjeshëm i mjeteve teknologjike dhe logjistike;

Objektivi specifik 3.3: Përkrahja në mirëqeniën e stafit;

V. PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit hartohet brenda kornizës së përgjithshme strategjike të përcaktuar në Planin Zhvillimor Strategjik të SHSK-së.

Plani i veprimit për zbatimin e këtij Planit Zhvillimor Strategjik përmbanë:

- 1. Objektivat strategjike;*
- 2. Objektivat specifike;*
- 3. Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave;*
- 4. Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv dhe aktivitet;*
- 5. Afatet kohore për realizimin e secilit objektiv;*
- 6. Burimet e nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve;*
- 7. Treguesit për realizimin e secilit objektiv dhe aktivitet.*

Objektivi Strategjik 1: Ngritja e sigurisë në komunitet

Objektivi specifik 1.1		Zbatimi efektiv i masave, dënimeve alternative dhe mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht				
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e nderlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputet
1	Standardizimi i metodave të punës	2026-2028	Shërbimi Sprovues / MD	MD	MD/Donacion	Formularët e punës të standardizuar
2	Standardizimi i instrumenteve për vlerësimin e rrezikut	2026 - 2028	Shërbimi Sprovues / MD	MD	MD/Donacion	Instrumenti i standardizuar
3	Përkrahja për grupet specifike në nevojë	2026-2028	Shërbimi Sprovues/ MD	MD	MD/Donacion	Rritja e pjesëmarrjes së grupeve përfituese

Objektivi specifik 1.2		Ngritja e vetëdijës dhe ndërgjegjësimit mbi përparësitë e dënimeve alternative				
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e nderlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputet
1	Kampanjat vetëdijesuese	2026-2028	SHSK/MD	MD	MD/Donacion	Sensibilizimi në komunitet i arritur
2	Promovimi i Shërbimit Sprovues në media sociale	2026-2028	SHSK/MD	MD	MD/Donacion	Mediat sociale të krijuara
3	Krijimi i web-it për SHSK-në	2026-2028	SHSK/MD	MD	MD/Donacion	Krijimi i web në finalizim e sipër
4	Identifikimi, analiza dhe vlerësimi i nevojave për trajnime	2026-2028	SHSK/MD	MD	MD/Donacion	Raporti i hartuar
5	Hartimi i programit të trajnimeve	2026-2028	SHSK/MD	MD, AKSP	MD/Donacion	Plani dhe programi i trajnimit i hartuar
6	Aftësimi i trajnerëve brenda institucionit	2026-2028	SHSK/MD	MD	MD/Donacion	TOT i realizuar

Objektivi specifik 1.3		Mbështetje efektive për rehabilitim dhe risocializim të personave të dënuar				
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e nderlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputet
1.	Programet e rehabilitimit	2026-2028	SHSK/MD	MD, OJQ	MD/Donacion	Programet e zbatuara
2.	Mbështetje e klientëve	2026-2028	SHSK/MD	MD/ OJQ	MD/Donacion	Rritja e numrit të klientëve përfitues
3.	Ofrimi i shërbimeve profesionale në komunitet	2026-2028	SHSK/MD	MD/ OJQ	MD/Donacion	Shërbimet e realizuara

Objektivi Strategjik 2: Forcimi i kapaciteteve organizative

Objektivi specifik 2.1		Forcimi i bashkëpunimit me akterët e nivelit qendror dhe lokal				
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e nderlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputet
1	Forcimi i bashkëpunimit me sistemin gjyqësor	2026-2028	SHSK/MD	KGJK, KPK	MD/Donacion	Bashkëpunimi me sistemin gjyqësor i arritur
2	Organizimi i tryezave të rrumbullakta	2026-2028	SHSK/MD	KGJK, KPK, AD, ASP, OA etj	MD/Donacion	Tryeza në zyrat rajonale të organizuara
3	Memorandume bashkëpunimi	2026-2028	SHSK/MD	KGJK, KPK, AD, ASP, OA etj	MD/Donacion	Marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara

Objektivi specifik 2.2		Forcimi i bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare				
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e nderlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputet
1	Pjesëmarrja në organizimet e CEP-it	2026-2028	ShSK/MD	CEP	MD/Donacion	Pjesëmarrje të rregullta
2	Organizimi i takimeve të rregullta me partnerët ndërkombëtar	2026-2028	SHSK/MD	MD/SHSK	MD/Donacion	Takime të rregullta

3	Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta	2026-2028	SHSK/MD	MD/SHSK	MD/Donacion	Aktivite vjetore të realizuara (4)
4	Organizimi i konferencave rajonale	2026-2028	SHSK/MD	MD/SHSK	MD/Donacion	Pjesëmarrje në konferenca rajonale
5	Shkëmbimi i përvojave me institucionet e sprovimit	2026-2028	SHSK/MD	MD/SHSK	MD/Donacion	Shkëmbimi i përvojave i realizuar
6	Organizimi i vizitave studimore	2026-2028	SHSK/MD	MD/SHSK	MD/Donacion	Vizitat e realizuara

Objektivi specifik 2.3		Forcimi i bashkëpunimit me organizata joqeveritare				
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e nderlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputet
1	Pjesëmarrja në rrjetin e organizatave me të cilat SHSK bashkëpunon dhe do bashkëpunojë	2026-2028	SHSK/MD	OJQ	MD/Donacion	Pjesëmarrje e realizuar në rrjetet e OJQ-ve siç është KOMF etj
2	Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit	2026-2028	SHSK/MD	Qendrore dhe Lokale	MD/Donacion	Marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara
3	Organizimi i takimeve me asociacionet ekonomike	2026-2028	SHSK/MD	OE	MD/Donacion	Takimet e realizuara

Objektivi Strategjik 3: Avancimi i kapaciteteve profesionale të Shërbimit Sprovues

Objektivi specifik 3.1		Ngritja e aftësive dhe shkathtësive profesionale të stafit të SHSK-së				
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e nderlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputet
1	Identifikimi, analiza dhe vlerësimi i nevojave për trajnime	2026-2028	SHSK/MD	Qendror dhe lokal	MD/Donacion	Raporti për nevojat e trajnimit i hartuar

2	Hartimi i programeve të trajnimeve	2026-2028	SHSK/MD	Qendror dhe lokal	MD/Donacion	Planprogrami i hartuar
3	Trajnime të specializuara	2026-2028	SHSK/MD	Qendror dhe lokal	MD/Donacion	Trajnimet e specializuara të realizuara

Objektivi specifik 3.2		Avancimi i mëtutjeshëm i mjeteve teknologjike dhe logjistike				
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e ndërlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputet
1	Avancimi i sistemit elektronik databaza	2026-2028	ShSK/MD	MD	MD/Donacion	Data baza e avancuar e realizuar
2.	Sigurimi i pajisjeve teknologjike dhe logjistike	2026-2028	SHSK/MD	MD	MD/Donacion	Paisjet e logjistike teknologjike të siguruara
3	Blerja e automjeteve	2026-2028	SHSK/MD	Qeveria /MFPT, donatorë tjerë	MD/Donacion	Automjetet e siguruara
4	Krijimi i hapësirave të punës	2026-2028	SHSK/MD	Qeveria /MFPT, donatorë tjerë	MD/Donacion	Hapësira të punës të siguruara

Objektivi specifik 3.3		Përkrahja në mirëqenien e stafit				
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet e ndërlidhura	Kostoja dhe burimi	Outputet
1	Organizimi i takimeve të përbashkëta në nivel të SHSK-së	2026-2028	SHSK	MD	MD/Donacion	Takimet e realizuara
2	Të sigurohet mirëqenia nga mjetet në dispozicion (logjistike, financiare etj)	2026-2028	SHSK/MD	MD	MD/Donacion	Aktivitetet që ndihmojnë mirëqenien psikoemocionale e realizuara
3	Ofrimi i mbështetjes psikologjike	2026-2028	SHSK/MD	MD	MD/Donacion	Mbështetje psikologjike e realizuar